

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË BORDIT INDUSTRIAL (BI)

Takimi i tretë i Bordit Industrial të Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit/ Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education

Data:
19.12.2023

Fillimi:
13:00

Përfundimi:
14:45

Lokacioni:

Universiteti i Prizrenit, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Salla e Amfiteatrit

Pjesëmarrësit:

1. Albana Milaimi, dekanë e FShJM-së
2. Skender Kokollari, sekretar i FShJM-së
3. Evelina Leka, Federata e Gjuetarëve të Kosovës
4. Refki Zogaj, Semenarna & Agronomi
5. Bashkim Gashi, Frigo term
6. Vesel Usaj, profesor, Universiteti i Prizrenit, Fakulteti Ekonomik
7. Denur Paçaku, Asistent i Programit
8. Ariel Shaban, Specialist i Marrëdhënieve me Industrinë
9. Arta Rrustemi, Menaxher e Financave dhe Operacioneve
10. Gentë Kadriu, Specialiste e Agrobiznesit

PËRSHKRIMI I TEMAVE TË TRAJTUARA DHE KONKLuzionET

Diskutim në BI

- **Albana Milaimi:** Projektin e shohim shumë frytëdhënës, jemi të lumtur. Agjencia e Akreditimit të Kosovës (AKA) na ka kërkuar t'i funksionalizojmë BKI-të para 6-7 viteve për akreditim. Ne gjatë kësaj radhe kemi çfarë t'i tregojmë AKA-së për aktivitetet e Bordeve Industriale.
- **Ariel Shaban:** Si projekt e kemi parë të rëndësishme t'i ndajmë disa detaje të Training of Trainers (ToT) dhe Panelit Korporativ (CP) me anëtarët e Bordit Industrial. Ideja është që nëpërmjet inicimit të praktikës, punës hulumtuese, klubeve studentore etj, t'i përgatisim studentët që të jenë më të gatshëm për tregun e punës. [Arieli e shpjegon qëllimin e Panelit Korporativ]. Ne besoj që kemi bërë punë të mirë me Panelet Korporative. Shënimet të cilat kanë dalur nga këto panele do t'ua dërgojmë e do të kemi mundësi që në takimet e ardhshme të bordit t'i shpjegojmë më gjerësisht. Mbetet të vazhdojmë të punojmë me dekanen për vitiin 2024 dhe ta bëjmë një plan të punës për këto borde dhe t'i shohim kompanitë aktive të cilat mund të marrin pjesë në borde.
- **Arta Rrustemi:** Ideja për planin e vitit 2024 për Bordet Industriale është që të kemi mbledhje jo edhe aq shpesh por ato të mbahen p.sh. çdo tre muaj dhe të njoftoheni shumë më herët. Gjatë muajit mars dhe prill do të formohet me universitetin një grup i ri i profesorëve që do të trajnohen për ToT. Gjatë nëntorit janë mbajtur këto mbledhje por do të mbahen edhe gjatë vitit të ardhshëm. Do të ju dërgojmë raporte njoftuese dhe do t'ua dërgojmë edhe këto power point prezantime. Njëra nga aktivitetet tjera është se projekti do të vazhdojë t'i ndihmojë universitetin, përkatësisht Qendrës së Karrierës përmes p.sh. mbledhjes së të dhënave dhe takimeve që do t'i kemi ne si aktivitet me kompanitë private. Gjatë nëntorit i kemi angazhuar studentët në klube të karrierës. Gjatë vitit të ardhshëm gjithashtu do të planifikojmë të vazhdojmë me trajnime për stafin akademik, të sjellim kompani të reja në bord dhe përgjithësisht do të përfundohen zinxhiri i aktiviteteve mes profesorëve dhe studentëve. Propozim kemi që në fund të janarit, ku ne e bëjmë një formë të thjeshtë të aktiviteteve të projektit, por kishte me qenë e mirëpritur që edhe ju të na i dërgoni kërkesat apo rekomandimet e juaja për aktivitete, temave të diskutimit e përpilimit të agjendave.

Pjesë tjetër e projektit është edhe puna praktike, ku studentët do të dërgohen në kompani. Pjesa tjetër është hulumtimi. Kemi kërkesa nga sektori privat ku atyre i'u duhen tema të ndryshme të hulumtimit dhe studentët me ndihmën e profesorëve mund t'i realizojnë këto hulumtime. Profesorët janë duke i bërë disa lista të temave për hulumtim për të cilat ne do të gjejmë ekspertë nga UI dhe ISU, përmes të cilëve do të tentojmë të angazhohemi për rezultate të cilat mund t'iu ndihmojnë edhe juve.

- **Albana Milaimi:** E kam të qartë se çfarë është bërë deri më tani. Ajo çfarë e keni planifikuar ju për vitin 2024 është shumë e mirë se ardhur. Curt Youngs më tha që do të jenë 3-4 profesorë, por nuk e dija a është për program apo për fakultet.
- **Gentë Kadriu:** Ata do të jenë për program, pra jo për fakultet.
- **Albana Milaimi:** Ne kemi edhe profesorë që janë shumë të mirë të cilët janë shumë të mirë por e kanë vështirë me gjuhën angleze. Ne aktualisht nuk kemi profesorë shumë, mirëpo do të angazhohemi për këtë pjesë në të ardhmen për të pasur profesorë që mund të angazhohen më shumë në projekt. Është me rëndësi ajo që thatë që të propozohen temat dhe ato të merren e më pastaj të diskutohen bashkërisht, ndoshta edhe bizneset me idetë e tyre na sjellin dicka që nuk na është kujtuar neve. U përmenden kurset e gjuhës angleze në takim nga unë, çfarë janë?
- **Gentë Kadriu:** Curt Youngs i përmendi kurset që do të mbahen për gjuhën angleze, mirëpo ato mund të jenë të hapura për të gjithë.
- **Albana Milaimi:** Në studimet master ne i kemi 4 lëndë që studentët i ndjekin ligjëratat në gjuhën angleze, provimet dhe literaturën. Studentët na dhanë një sugjerim në një nga mbledhjen e fundit të BKI, ku ata kërkuan që në program ta keni lëndën e Anglishtës 2.
- **Bekim Gashi:** Më pëlqeu shumë prezantimi që u bë. Ne si asociacion kombëtar kemi partneritete me organizata dhe institucione të tjera përmes të cilave kemi mësuar shumë, janë hapa të tjerë dhe zhvillim krejt tjetër. Përveç profesorëve është me rëndësi që edhe studentët të bëjnë vizita studimore. Unë inkurajoj që USAID të na përkrahë për vizita studimore në loëa në ShBA.

AKTIVITETE TË PLANIFIKUARA (NËSE KA)			
	AKTIVITETI	PËRGJEGJËSIA	AFATI I FUNDIT
	N/A	N/A	N/A

Denur Paçaku

Pogram Assistant,
Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education,
USAID Grantee,
Iowa Consortium, University of Iowa,
Prizren, Kosovo, 20 000 (GMT +2),
Mobile: +383 48 265 012.

IOWA